

VENDIM
Nr. 930, datë 29.12.2014

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 547, DATË 9.8.2006, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 547, datë 9.8.2006, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 5 e 7 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“5. Agjencia Kombëtare Burimeve Natyrore nuk financohet nga buxheti i shtetit. Megjithatë, agjencia ka të drejtë të përfitojë projekte të financuara nga buxheti i shtetit apo nga subjekte të tjera. Buxheti i agjencisë miratohet nga ministri i Energjisë dhe Industrisë.”.

“7. Funksionimi, struktura organizative dhe struktura e pagave të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore përcaktohen në statutrregulloren e kësaj agjencie, e cila miratohet me urdhër të ministrit të Energjisë dhe Industrisë. Marrëdhëniet e punës së punonjësve rregullohen në bazë të Kodit të Punës.”.

2. Në fund të pikës 8 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Drejtori ekzekutiv, për efekt të pagës, klasifikohet në të njëjtin nivel me sekretarin e Përgjithshëm të ministrisë së linjës.”.

3. Kudo në vendim, emërtimi “Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës” zëvendësohet me “Ministria e Energjisë dhe Industrisë”.

4. Në lidhjen nr. 1, që përmendet në pikën 3, dhe bashkëlidhur vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, ndarja me numër rendor 25 shfuqizohet.

II. Ngarkohet ministri i Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama